



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1000/23 Datë: 26/07/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, mori:

**V E N D I M**

- I. Rikreditohen programet e studimit të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2023 - 30 shtator 2028):
  1. *Juridik LLB, 240 ECTS R; me kuotën maksimumi 600 studentë për vit akademik;*
  2. *Kontratata dhe e Drejta Komeriale LLM, 60 ECTS, R; me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
  3. *Studime të Avancuara Evropiane LLM, 60 ECTS, R; me kuotën maksimumi 25 studentë për vit akademik;*
  4. *E Drejta Financiare LLM, 60 ECTS, R; me kuotën maksimumi 35 studentë për vit akademik;*
- II. Akreditohen/Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026):
  1. *Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale LLM, 60 ECTS, A; me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik;*
  2. *E Drejta Civile dhe Pronësore LLM, 60 ECTS, R; me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
  3. *E Drejta Ndërkombëtare LLM, 60 ECTS, R; me kuotën maksimumi 35 studentë për vit akademik;*
  4. *E Drejta Penale LLM, 60 ECTS, R. me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve si në paragrafin I zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2023 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.

VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.

VII. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I dhe II, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Juridik LLB, 240 ECTS, R</i>	<i>Qerim Qerimi Besfort Rrecaj Luljeta Plakolli Kasumi Fitore Morina</i>
2.	<i>Kontratat dhe e Drejta Komeriale LLM, 60 ECTS, R</i>	<i>Valbon Mulaj</i>
3.	<i>Studime të Avancuara Evropiane LLM, 60 ECTS, R</i>	<i>Enver Hasani</i>
4.	<i>E Drejta Financiare LLM, 60 ECTS, R</i>	<i>Arton Nuhiu</i>
5.	<i>Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale LLM, 60 ECTS, A</i>	<i>Fisnik Korenica</i>
6.	<i>E Drejta Civile dhe Pronësore LLM, 60 ECTS, R</i>	<i>Rrustem Qehaja</i>
7.	<i>E Drejta Ndërkombëtare LLM, 60 ECTS, R</i>	<i>Hajredin Kuqi</i>
8.	<i>E Drejta Penale LLM, 60 ECTS, R</i>	<i>Avni Puka</i>

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Juridik LLB, 240 ECTS R*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Peter Parycek dhe Domagoj Svirig, është organizuar më 03.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5), Substancialisht një (1), Pjesërisht një (1) standarde.
2. Për programin e studimit; *Kontratat dhe e Drejta Komeriale LLM, 60 ECTS, R*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Bertel De Groote dhe Domagoj Svirig, është organizuar më 04.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5), Substancialisht një (1), Pjesërisht një (1) standarde.



3. Për programin e studimit; *Studime të Avancuara Evropiane LLM, 60 ECTS, R*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Dunja Duic dhe Asnate Kazoka është organizuar me 05.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht pesë (5), dhe Pjesërisht një (1) standarde.
4. Për programin e studimit; *E Drejta Financiare LLM, 60 ECTS, R*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Bertel De Groote dhe Horia Serban Onita, është organizuar me 19.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4), Substancialisht dy (2) dhe Pjesërisht një (1) standarde.
5. Për programin e studimit; *Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale LLM, 60 ECTS, A*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Peter Parycek dhe Horia Serban Onita, është organizuar më 22.02.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4), Substancialisht dy (2), Pjesërisht një (1) standarde.
6. Për programin e studimit; *E Drejta Civile dhe Pronësore LLM, 60 ECTS, R*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Peter Parycek dhe Fatima Zahra, është organizuar më 04.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht dy (2), standarde.
7. Për programin e studimit; *E Drejta Ndërkombëtare LLM, 60 ECTS, R*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Johannes Falterbaum dhe Fatima Zahra, është organizuar më 05.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3), Substancialisht tre (3) Pjesërisht një (1) standarde.
8. Për programin e studimit; *E Drejta Penale LLM, 60 ECTS, R*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Peter Parycek dhe Giga Khositashvilli, është organizuar më 08.06.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) Substancialisht dy (2), dhe Pjesërisht dy (2), standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

